URDHËR
Nr.328, datë 18.5.2020

"PËR DISA SHTESA NË URDHRIN NR.279, DATË 25.4.2020 "PËR LEHTËSIMIN E POSAÇËM TË LËVIZJES NË "ZONAT E GJELBËRTA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr.15/2016,"Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe vendimit nr. 2357, datë 16.5.2020 të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirus i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullтës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 279 datë 25.4.2020 "Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në "Zonat e Gjelbërta", të ndryshuar bëhet shtesa dhe ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1, pas fjalës "Peqin", shtohet fjala "Fier".
2. Pikat 2 dhe pika 3, shfuqizohen.
3. Në pikën, 6 togfjalëshi "nga ora 09:30 deri në orën 21:30", shfuqizohet.
4. Pika 6/1 shfuqizohet.
5. Çdo parashikim i mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu